

Përfaqësuesit e KLSH-së marrin pjesë në workshop-in e zhvilluar në Podgoricë mbi “Monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit”

Në datën 11 Mars 2022, në Podgoricë u zhvillua workshop-i me temë *“Monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit”* organizuar nga Fondacioni Westminster për Demokraci në Mal të Zi, në bashkëpunim me Institucionin Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësuesit e institucioneve supreme të auditimit të rajonit si dhe përfaqësues nga institucionet supreme të auditimit të Britanisë së Madhe dhe Belgjikës. KLSH u përfaqësua nga audituesit Alban Polovina dhe Rigels Guzi. Qëllimi i këtij takimi ishte ndarja e eksperiencave dhe praktikave më të mira për përmirësimin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit, që luajnë një rol kryesor në matjen e ndikimit të auditimit.

Nga ana e përfaqësuesit të institucionit suprem të auditimit të Belgjikës, njëkohësisht edhe kryesues i grupit të punës të EUROSAT-t, u prezantua *“Udhëzuesi i praktikave më të mira për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit”* publikuar në janar 2021, i hartuar mbi kriteret e raporteve cilësore të auditimit, marrëdhëniet e mira me subjektet e audituara, ekzistencën e sistemit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, përfshirjen e parlamentit, raportimin e rezultateve të zbatimit të rekomandimeve dhe përdorimin e tyre për vlerësimin e performancës dhe risqeve.

Përfaqësuesit e KLSH-së në prezantimin e tyre, paraqitën një përmbledhje mbi procesin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga institucioni, kuadrin ligjor mbi të cilin realizohet ky proces, si dhe manualin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe regjistrin institucional të rekomandimeve miratuar me Vendimin nr. 67 datë 23.06.2020.



Përveç shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira të institucioneve supreme të auditimit, gjatë aktivitetit, u diskutua edhe për përmirësimin e cilësisë së rekomandimeve të dhëna nga institucionet supreme të auditimit si një kontribut i vlefshëm në mirëqeverisje.

Një fokus i veçantë ju kushtua diskutimeve për përmirësimin e marrëdhëniet me parlamentin dhe rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve, në kuadër të zbatimit të kërkesave të Komisionit Evropian për proceset integruese paraqitur në Progres Raportet respektive.